



## KUVENDI I KOMUNËS KLINË

Shërbimi për Punë të Kuvendit

01 Nr. 06-4963/14

Klinë, më 12.11.2014

## EKSRAKT-PROCESVERBALI

Nga mbledhja e radhës e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datën **17.11.2014**, në sallën e Kuvendit të Komunës, me fillim në orën **10:00**.

### R e n d i i d i t ë s :

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit financiar për përudhen janar-nëntor 2014,
4. Inicimi i procedurës së Projekt-rregullores për transparencë dhe Propozim-vendimi për vënie në diskutim publik,
5. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit komunal për të zhdukurit për zyrtarizimin e Ditës së të zhdukurve më datën e 4 Prillit,
6. Njoftim lidhur me përgatitjet e caktimit të orarit kalendarik të punës së Kuvendit dhe të Komiteteve për vitin 2015,
7. Të ndryshme.

Në mbledhje ishin prezent:

1. Dr. Haxhi Ibishi.....Kryesues
2. Ramush Agushi .....anëtar
3. Halil Desku..... anëtar
4. Pal Berisha ..... anëtar
5. Avni Gashi..... anëtar
6. Fadil Gashi..... anëtar
7. Ndue Shabanaj..... anëtar

Pjesëmarrës të tjera ishin: Ramiz Rrusta –drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, përfaqësues të OSBE-së, të Zyrës Ligjore, mediet, Samije Gjergji, Agron Gashi, OJQ-të, Lale Grabanica, Atifete Bytyqi, kryetare e Komisionit Komunal për të Zhdukurit e tjera.

Mbledhjen e hapi Dr. Haxhi Ibishi i cili pasi i përshëndeti të pranishmit i lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në këtë mbledhje.

*Rendi i ditës u miratua unanimisht nga anëtarët e KPF-së.*

*Pika e I-rë: Arsyetimi i mungesave.*

Dr. Haxhi Ibishi, tha së të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa janë prezent në mbledhje.

**Pika e II-të: Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar.**

*Procesi i mbledhjes së kaluar u miratua unanimisht.*

**Pika e III-të: Shqyrtimi i Raportit finansiar për periudhën janar-nëntor 2014.**

Ramiz Rrusta- drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, tha se buxheti në SMFK i shpenzuar për periudhën janar-shtator 2014 ishte në vlerë prej 6.027,874.40 € , e krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë rritur për 11.62%, dhe shtoi së në tabelën numër 5 i keni krahasimet e shpenzimeve në përqindje. Drejtori Rrusta, në vazhdim sqaroi që secila drejtori në mbledhjen e Kuvendit do t'i paraqes shpenzimet e kryera gjatë kësaj periudhe raportuese.

Avni Gashi, tha së është mirë që janë ndarë shpenzimet nëpër drejtori, por nuk është mirë për shpenzimet që janë të bartura nga viti i kaluar, pastaj pagesat që bëhen me vendime gjyqësore, mendoj se duhet për të gjetur një mënyrë për t'i parandaluar këto.

Fadil Gashi, pyeti se ka mundësi që në seancën e ardhshme të Kuvendit të na sjellët regjistri i shpërndarjes së subvencioneve dhe mendoj se do të ishte mirë që të merret iniciativë për hartimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve. Ai tha se e kemi edhe Ligjin për ndarjen e subvencioneve.

Avni Gashi, tha se edhe unë mendoj se duhet të këtë një rregullore të veçantë për ndarje të subvencioneve.

Ramiz Rrusta, theksoi se sa i përket pagesave që bëhen në bazë të vendimeve gjyqësore, është e vërtetë së janë paguar 11 mijë euro, por nuk është vetëm kjo, kemi raste edhe në Drejtorinë e Kulturës, në muajin janar të vitit të ardhshëm kanë për t'u paguar edhe disa konteste të tjera."Ndërsa sa i përket subvencioneve, unë do të përpinqem ta bëj regjistrin e këtyre përfituesve dhe se asnjë subvencion nuk paguhet pa vendim të Zyrës Ligjore dhe miratimin e Kryetarit të Komunës".

KPF preferon që Raporti finansiar për periudhën janar-shtator 2014 të bartet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Kuvendit.

**Pika e IV-të:** Inicimi i procedurës për projekt-Rregulloren për transparencë në Komunën e Klinës dhe propozim-vendimi për vënie në diskutim publik.

KPF preferon që Projekt-rregullorja për transparencë në Komunën e Klinës dhe Propozim-vendimi për vënie në diskutim publik të bartet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

**Pika e V-të:** Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit komunal për të zhdukurit që të zyrtarizohet Dita e 4 prillit.

Atifete Bytyqi (kryetare e Komisionit Komunal për të Zhdukurit), tha se Komisioni Komunal për të Zhdukurit kërkon nga Komuna që data e 4 Prillit të zyrtarizohet si datë e veçantë, e për këtë propozim e kemi pëlqimin edhe të Kryetarit të Komunës dhe edhe të Kryesuesit të Kuvendit.

**Avni Gashi**, potencoi se një iniciativë e tillë ka qenë edhe me herët dhe mendoj që kjo është mjaft e nevojshme që ta kemi një datë zyrtare për të zhdukurit.

**Ramush Agushi**, tha se unë e përkrah këtë kërkesë dhe propozoj që të bartet për Kuvend.

KPF preferon që kjo kërkesë të bartet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Kuvendit.

**Pika e VI-të:** Njoftim me përgatitjet e caktimit të orarit kalendarik të punës së Kuvendit dhe të Komiteteve për vitin 2015 ( për seancën e dhjetorit).

KPF të bëhen përgatitjet për Kalendarin e punës së Kuvendit dhe të komiteteve për vitin 2015.

**Pika e VII-të :**Të ndryshme.

**Dr. Haxhi Ibishi**, tha se kemi një kërkesë nga lagja tek livadhet e fshatit Gjurgjevik i Vogël për asfaltimin e rrugës lokale në shtrirje prej 700 metrash, këtë kërkesë e bartim tek Drejtoria e Urbanizmit me preferencën së është shqyrtuar nga KPF-ja.

Me kaq mbledhja e KPF-së përfundoi punën në orën 11:00.

Procesmbajtësi,  
Beqir Gashi

Kryesuesi i KPF-së,  
Dr. Haxhi Ibishi

